



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr.103/01-17159 /19

Kaçanik, 12.06.2019

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 30 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës si dhe kërkesën e Drejtorisë për arsim dhe kulturë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **z. Enver Kamishi** emërohet ushtrues i detyrës së Drejtorit të SH.M.P “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” në Kaçanik.

2. Detyrën e Drejtorit të shkollës z.Enver Kamishi do ta ushtrojë prej dt. 13.06.2019 deri më 13.09.2019.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për arsim dhe kulturë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Drejtori i SH.M.P “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” në Kaçanik, z. Zekirja Baftiu është pezulluar përkohësisht nga detyra i tij sipas vendimit 1Nr.610/01-16393/2019 të datës 05.06.2019.

Prandaj për të plotësuar këtë pozitë të rëndësishme dhe të domosdoshme, Drejtoria për arsim dhe kulturë ka kërkuar që përkohësisht të caktohet një punëtor për të ushtruar këtë detyrë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u cekën më lartë si dhe legjislacionin në fuqi u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh prej ditës së pranimi të këtij vendimi në komisionin për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve tjera.

Me këtë vendim njoftohet:

z. Enver Kamishi,
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë,
Zyra e personelit dhe
Arkivi.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS

01.104/02- 17628/19

Kaçanik.17.06.2019

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28.04, qershor 2008), si dhe Rregullores (QRK) Nr.13/2017 për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar, Strategjisë Shtetërore për Ri-integrimin të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019 - 2022 kryetari i komunës së Kaçanikut me datën 17.06.2019 merr :

V E N D I M

Themelohet Grupi Punues për hartimin e Planit lokal te Veprimit për Ri-integrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar me këtë përbërje:

- | | |
|-------------------|--|
| 1. Fadil Guri | - ZKKK (Kryesuese), |
| 2. Edmond Mjaku | - Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, |
| 3. Diana Reka | - Drejtoria për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale |
| 4. Bukuriye Sopa | - Qendra për Punë Sociale, |
| 5. Gafurr Guri | - Drejtoria për Arsim, |
| 6. Hidajete Guri | - Integritime Evropiane, |
| 7. Bujar Bajra | - Drejtoria për Shërbime Publike, |
| 8. Memet Mulaku | - Zyra e punësimit e Punësimit, |
| 9. Jehona Hoxha | - zyrtare e Urbanizmit, |
| 10. Driton Halili | - Koordinator Rajonal për Ri-integrim, |
- I. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Grupi Punues obligohet të ndërmarr të gjitha veprimet për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Ri-integrim, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e ri-integrimit të personave të riatdhesuar në komunë.
- II. Obligohen të gjitha njësit tjera brenda komunës që ti ofrojnë mbështetje Grupit Punues.
- III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

I dërgohet:

1. Arkivit
2. Anëtarëve të Komisionit

Kryetari i Komunës

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01.Nr. 104/02-19201/19
Kaçanik, 26.06.2019

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale neni 13 dhe neni 58 dhe në pajtim me Rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planëve të veprimit e datës 21.06.2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

I

Formohet Komisioni për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të jashtëm për PFV'2018

II

Komisioni ka këtë përbërje:

- 1-Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Kryesues
- 2- Festim Neziraj, Drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
- 3-Ukshin Çallaku, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mjedisit
- 4-Ilir Krivanjeva, Zyrtar për regjistrimin e pronave të paluajtshme
- 5-Hasan Kriva, Zyrtar i pranimit
- 6-Arsim Zenuni, Zyrtar për llogaritje dhe pagesa
- + 7-Izahir Kuka, Zyrtar i prokurimit
- + 8-Murat Burrniku, Zyrtar i personelit

III

Komisioni do ta kryej funksionin në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi dhe nenit 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planëve të veprimit.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi ditën marrjes.

V

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen : Anëtarët e komisionit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Z.Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01.Nr. 104/02 - 19232/19
Kaçanik, 26.06.2019

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

VENDIM

I

Formohet Komisioni për Hartimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe ngarkesa tjera administrative.

II

Komisioni ka këtë përbërje:

- 1-Festim Neziraj, Drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Kryesues
- 2- Menduh Krasniqi, Shef i shërbimeve publike
- 3-Arben Fera, Inspektor i tregut
- 4-Ilir Krivanjeva, Zyrtar për regjistrimin e pronave te paluajtshme
- 5-Betim Shala, Zyrtar për Urbanizëm

III

Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi është hartimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe ngarkesa tjera administrative.

IV

Për kryerjen e detyrës si në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën marrjes.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Z.Besim Hazi